



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Biznesi”

ofruar nga

Universiteti POLIS

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ermira Qosja

Prof. Asoc. Dr. Jonida Teta

Qershor/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Administrim Biznesi”

1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Administrim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr. 429. Dt.18/07/2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin 2024-2025: 15 PAE / 6PAK (71%/29%) 2023-2024: 15 PAE/ 6 PAK 2022-2023: 15 PAE/ 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2022- 2023 –15 studentë 2023-2024 – 17 studentë 2024-2025 – 33 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti POLIS është IAL privat i themeluar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 35386 datë, 04.04.2006, si dhe Licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM Nr. 698, datë 11.10.2006. POLIS është akredituar institucionalisht për herë të parë me Urdhër të Ministrisë Arsimit dhe Shkencës Nr. 227, datë 22.07.2009; ri-akredituar institucionalisht për herë të dytë me Urdhër të Ministrisë Arsimit dhe Sportit Nr. 267, dateë 20.05.2016; ri-akredituar institucionalisht për herë të tretë nga QAA dhe ASCAL me Vendim Nr. 113, datë 15.12.2017, si dhe ri-akreditim institucional ndërkombëtar për herë të katërt nga QAA datë 18.12.2023.

Universiteti POLIS sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij 3 fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn;
2. Fakulteti Planifikim. Mjedis dhe Menaxhim Urban
3. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim

Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban në përbërje të tij ka:

1. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë
2. Departamenti Planifikim dhe Mjedis
3. Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit

Në strukturën e programeve të Departamentit të Menaxhimit dhe Biznesit bëjnë pjesë dhe dy programe studimi me profil ekonomik: Bachelor në Administrim Biznesi, Master i Shkencave në Administrim Biznesi të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë si dhe në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit BA në AB janë në përputhje të plotë me ato të POLIS, ky program përforcon një nga parimet e “teknologjisë Polis” në hartimin e programeve - ndërdisiplinaritetin. Vlen të theksohet se ndonëse programi është në vitin e tretë të tij numrat e studentëve kanë ardhur në një rritje. Objektiva të rëndësishme të këtij programi janë dhe lidhja e studentëve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Asoc. Dr. Jonida Teta. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Rajna Lila

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznes”, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban në POLIS, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të mermin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në POLIS, u realizua në datën 25 dhe 26 Mars 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në POLIS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Biznesit, Dekanin e Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, Zvrektoreshen e cilësisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, NJSBC, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Zyrën e Ndërkombëtarizmit dhe Projekteve; si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit bachelor në AB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacionin e depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Më datë 04.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/19 Prot., Datë 04.06.2025, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 544/25 Prot, Datë 11.06.2025.

Mbi komentet e institucionit lidhur me Draft- Raportin e Vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” të Universitetit Polis.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al




GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më poshtë po rendisim sqarimet tona për komentet e bëra prej institucionit.

Konkretisht:

1. Lidhur me komentin nga IAL që bëhet për Emërtimi Departamentit në Tabelën Përmbledhëse :
Gvj është shprehur në drvj që i përket Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban.
Gvj pas ridergimit të shkreses nga MAS për miratimin e ndryshimit të emertimit të njësisë bazë (departamentitë) pranon ndryshimin e reflektuar dhe në raport.

Departamentin e Menaxhimit dhe Biznesit, të miratuar me vendim senati të Universitetit Polis nr.5, datë 27.02.2024 dhe me kthimë përgjigje shkresë MAS nr.prot 7298/1 dt. 18.02.2025.


2. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e parë, Standardi I.1. Kriteri 3, paragrafi 3 – në komentin e tij UP konfirmon çfarë është rekomanduar nga GVJ.
Gvj e mere në konsiderat komentin e institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
3. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e parë, Standardi I.2. Kriteri 1, Paragrafi 3 – GVJ vlerëson modalitetet dhe praktikatat e brëndshme dhe sugjeron një Rregullore për Praktikën, e cila në thelbin e vet do të kontribuojë në pëmirësimin e vazhdueshëm të këtij elementi të programit mësimor.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
4. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.1 Kriteri 1 Paragrafi 3 – GVJ rikonfirmon sugjerimin që ngarkesa leksion /seminar për vetë tipologjinë e lëndëve të BA në AB duhet sistemuar në raportet 2/2 ose 3/1, për më tepër vete UP rikonfirmon sistemimin pas akreditimit të parë.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
5. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.1 Kriteri 2 Paragrafi 2 – GVJ konstaton se në këtë program studimi vetë UP në paragrafin e fundit të komentit e rikonfirmon sugjerimin.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
6. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.1 Konkluzione- GVJ vlerëson që UP në të gjitha komentet e tij e ka rikonfirmuar vlerësimin e bërë dhe sugjerimin.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.



7. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.2 Kriteri 1 & 2 dhe Standardi II.2 Konkluzionet – GVJ i referohet krijimit të grupeve lëndore brenda departamentit.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
8. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.3 Kriteri 4- Sugjerimi i GVJ respekton lirinë akademike, dhe mbetet i qëndrimit që në respekt të standardeve dhe kriterëve duhet të vlerësohet mënyra e kontrollit të njohurive, lëndë të së njëjtës tipologji duhet të kenë tipologji të njëjtë vlerësimi. Në lidhje me silabuset, një pjesë e tyre janë sipas VKM, pjesa tjetër nevojitet të plotësohen duke marrë në konsideratë sugjerimin e GVJ.
Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.
9. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Për sa më sipër konkluzionet për Standardi II.3 Konkluzione – mbeten të pandryshuara, e njëjta qasje dhe për Standardi II.4 Kriteri 5.
10. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II.5 Kriteri 2 – GVJ vlerëson që përpos gjithë raportit që departamenti formëzon me studentët, mbledhjet periodike me ta, grupe dhe nivele të ndryshme studimi duhet të bëhen me tematika të caktuara, me frekuencë mujore. *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
11. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi III.3 Kriteri 2- *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
12. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi III.4 Kriteri 4- GVJ rekomandon që programi i studimit të ofrojë punë laboratorike për disa lëndë specifike në fushën e “Biznesit Dixhital”, *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport*
13. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi III.5 Kriteri 6 *Vlerësojmë komentin e Institucioni në të cilin ka dryshime në raport dhe kjo është reflektuar.*
14. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi V.4 Kriteri 6 *Vlerësojmë komentin e Institucioni në të cilin ka dryshime në raport dhe kjo është reflektuar.*



15. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi IV.Kriteri 2
*Vlerësojmë komentin e Institucioni në të cilin ka dryshime në raport dhe kjo është
reflektuar*



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Biznes”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti POLIS është produkt i “ndjenjës dhe nevojës së ndryshimit” që zë fill me themelimin e Co-PLAN, si një institut joqeveritar profesional që lobon në favor të pjesëmarrjes së publikut në procese transparente të planifikimit e zhvillimit urban/mjedisor, në funksion të qeverisjes së mirë. Në 2006, kjo qendër u shndërrua në konceptin fillestar të një IAL-je, që u quajt fillimisht: “POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban”. Misioni i POLIS është sigurimi i ‘Njohurive, Teknologjisë dhe Lidershipit’, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe nëpërmjet edukimit akademik që krijon e përmirëson kompetencën kreative dhe gjithëpërfshirëse. POLIS i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së studentëve në edukimin bazuar tek kërkimi shkencor, duke u angazhuar në projekte të komunitetit, shërbime konkrete për qeverisjen vendore. Universiteti “POLIS”, zhvillon të gjithë veprimtarinë e tij, në përputhje me Ligjin Nr. 80 të vitit 2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Programi BA në AB është në përputhje me dokumentat e qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020); Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023-2030).
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi Bachelor në: “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me Misionin e universitetit të shprehur në Statutin e tij, Strategjinë e Zhvillimit të institucionit për periudhën 2022-2026 si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të programit 2024. Programi BA në AB është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe një sërë aktesh nënligjore që e kanë shoqëruar në vite atë. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren e Universitetit dhe në Rregulloren e Programit të studimit, bëhet e mundur menaxhimi i programit brenda shinave ligjore dhe rregullativë.



Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<u>GVJ vlerëson që, Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë brenda Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si Fakulteti i Kërkim Zhvillimit në POLIS, kanë të gjitha kapacitetet për t'u përqasur përmes një studimi tregu të fokusuar në kompetencat që kërkohen në tregun shqiptar dhe europian, në përvoja europiane dhe rajonale të ngjashme, si dhe në sjelljet e qëndrimet e studentëve në këtë epokë të re – proces që sugjerohet të zhvillohet pas akreditimit të parë të programit BA në AB.</u> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 09. Strategjia e zhvillimit të Universitetit POLIS2021-2026</i> <i>Dokumenti Aneksi 12: Strategjinë e zhvillimit të programit 2024</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 48: Misioni dhe studim i tregut</i>											
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	POLIS zhvillon veprimtarinë e tij në tregun e Arsimit të Lartë në Shqipëri prej afro 20 vitesh, duke ofruar një model shkolle të lartë me një qasje shumë proaktive ndaj projekteve, ndërkombëtarizmit dhe inovacionit. Në POLIS ofrohen studime në katër nivele: Shkollim Profesional, Bachelor, Master Profesional dhe i Shkencave, Master Ekzekutiv dhe programe Doktorale, si dhe kurse dhe çertifikata pasuniversitare trajnimi të vlefshme për licensime. POLIS ka shkuar drejt hapjes së programit Bsc në AB përmes një procesi që ndryshon nga përvoja e shkollave të tjera në Shqipëri. Përvoja 10 vjeçare në programin e MP. AB (master professional) të ofruar në bashkëpunim me IPAG Business School Paris dhe ndryshimet ligjore në process, nga njëra anë çuan në transformimin e MP në MSH, nga ana tjetër në dizajnin dhe licensimin e programit BA në AB, duke ofruar kështu një cikël të plotë studimi në administrim biznes në përputhje me procesin e Bolonjës. Fakulteti Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban në vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 51 pedagogë, nga të cilët 28 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 23 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakultetit të Planifikimit, Mjedis dhe Menaxhim Urban</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>2</td><td>1</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Fakultetit të Planifikimit, Mjedis dhe Menaxhim Urban		PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	Prof.Asoc	2	1
Kualifikimi i stafit	Fakultetit të Planifikimit, Mjedis dhe Menaxhim Urban											
	PAE	PAK										
Prof.Dr	1	1										
Prof.Asoc	2	1										

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al



	Dr/PhD	16	10																				
	Msc	4	11																				
	Gjithsej	28	23																				
Ndërsa Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2024-2025, ka këtë paraqitje:																							
	<table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>10</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>9</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>12</td><td>15</td></tr></table>			Kualifikimi i stafit	Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit		PAE	PAK	Prof.Dr	-	1	Prof.Asoc	2	1	Dr/PhD	10	4	Msc	-	9	Gjithsej	12	15
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit																						
	PAE	PAK																					
Prof.Dr	-	1																					
Prof.Asoc	2	1																					
Dr/PhD	10	4																					
Msc	-	9																					
Gjithsej	12	15																					
Dokumenti Aneksi 09. Strategjia e zhvillimit të Universitetit POLIS2021-2026 Dokumenti Aneksi 12: Strategjinë e zhvillimit të programit 2024 Dokumenti: RVB BA administrim biznes Dokumenti Aneksi 07: Marrëveshja me IPAG. Dokumenti Aneksi 39: Të dhënat tabelore Ascal																							
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit si pjesë e Fakultetit të Planifikimit, Mjedis dhe Menaxhim Urban që në përbërje të tij ka: 1. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë 2. Departamenti Planifikim dhe Mjedis 3. Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit Përputhshmëria e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me fushën akademike e kërkimore të departamentit është bërë e mundur nga kodifikimi i programeve të studimit dhe lëndëve. E reflektuar edhe në dokumentat strategjike të departamentit, fakultetit dhe POLIS, programi ka për qëllim që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për të qënë sa më të aftë dhe konkurrues në fushën e ekonomisë dhe biznesit si dhe tregut lokal apo ndërkombëtar të punës. Në lidhje me përputhshmërinë e programit me fushën specifike të njësisë kryesore, besoj kjo është ezaruar në momentin e marrjes së vendimit të licensimit nga MAS. Ajo çka duhet vlerësuar është																						

	ndryshimi i bërë për ta alokuar programin në Departamentin e Menaxhimit dhe Biznesit, të miratuar me vendim senati të UP nr.5, date 27.02.2024 dhe me kthimë përgjigje shkresë MAS nr.prot 7298/1 dt. 18.02.2025. Dokumenti Aneksi 09: Strategjia e zhvillimit të Universitetit POLIS2021-2026 Dokumenti Aneksi 12: Strategjinë e zhvillimit të programit 2024 Dokumenti: RVB BA administrim biznes Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshmë			
Konkluzione	GVJ vlerëson që Departamenti MB përmbush plotësisht këtë standard në lidhje me këtë program studimi dhe <u>sugjeron</u> një përjasje me proaktive ndaj ndryshimit dhe përshtatjes së tij me dinamikat që koha shtron përpara universiteteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	POLIS drejton të gjithë veprimtarinë e vet akademike dhe administrative në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe udhëzimet e MAS, mbi këtë bazë është hartuar Statuti dhe Rregullorja e Universitetit "POLIS". Nga pikëpamja procedurale dhe e rregulloreve, njësitë kryesore dhe bazë kanë hartuar rregulloret e tyre, të cilat drejtojnë veprimtarinë e përditshme të tyre. GVJ <u>sugjeron</u> hartimin e Rregullores së departamentit, Rregulloren e Praktikës Mësimore dhe tërësinë e dokumentave të praktikës, si dhe Manualin e Cilësisë. Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme Dokumenti Aneksi 10. Organigrama e universitetit Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi

	<i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 35: Rregullore e Kodit të Etikës</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregullore Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti POLIS është një institucioni që karakterizohet nga një dimension i spikatur ndërkombëtar, gjë që reflektohet në programet e studimit, përbërjen e stafit akademik, studentët por dhe në shkëmbimet intensive dhe të larmishme me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë si në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore e didaktike ashtu dhe në shkëmbime të vazhdueshme dhe mobilitet të lartë mes stafit akademik dhe studentëve. POLIS është universiteti i parë shqiptar nënshkruar zyrtar i Observatorit të Kartës së Bolonjës: "Magna Charta Universitatum" në Itali.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	POLIS ka një rrjet të zgjeruar të partnerëve kombëtare dhe ndërkombëtarë. Partnerët dhe llojet e bashkëpunimit variojnë nga partneritetet afatgjata strategjike, me të cilët ofron programe akademike të përbashkëta dhe projekte kërkimore të përbashkëta, në partnerë ad hoc të përzgjedhur për veprimtari të caktuara si ëorkshop-et e përbashkëta, veprimtari të kërkimore të përbashkëta dhe skema për mobilizim të personelit dhe studentëve. Partnerët e POLIS sipas llojit të bashkëpunimit: - ANËTARËSIME - IAL - INSTITUCIONE QEVERITARE - ORGANIZATA PROFESIONALE - KOMUNITETI I BIZNESIT, TREGU I PUNËS <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Gjatë takimit me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, pedagogët dhe GVB, diskutuam për mënyrën si merret dhe analizohet feedback-u i bashkëpunimit me të tretët. U dakordësuam që tradita dhe përvoja e fituar, duhet dokumentuar dhe analizuar, jo thjesht në raportet dhe mbledhjet rutinë e shumë statike që formulohen çdo vit akademik. Në nivel universiteti është e qartë që ka një qasje shumë proaktive drejt misionit të tretë të tij, ndërkohë departamenti duhet të angazhohet më tepër dhe të krijojë një imazh të vetin brenda Universitetit POLIS.

	Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit Dokumenti: RVB BA administrim biznes			
Konkluzione	GVJ vlerëson se në lidhje me këtë standard, Universiteti Polis, është shumë proaktiv si në marrëveshje ndërkombëtare ashtu dhe kombëtare. Ekspertët vlerësojnë se ky standard përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër. Ky program studimi është në përputhje me Sistemin e Bolonjës. Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit Bsc në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e U.POLIS dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <u>Lëndët janë kryesisht me 6 ECTS (vetëm dy prej tyre me 3 ECTS), duke patur ndryshime në numrin e orëve mësimore, dhe një raport leksione/seminare që lëviz nga 24/36, në 36/24 dhe 48/12 logjika e të cilit mbeti e pashpjegur bazuar në udhëzimet e MAS dhe në takimin në institucion. (arsyetimi i bërë ishte që nuk dallojmë leksionin nga seminari sepse klasat janë të vogla).</u> Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

	modul në orë dhe kredite. Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi Bsc në AB është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 31, përfshirë praktikën dhe diplomën; - ngarkesa mësimore 4470 orë: 1774 orë në auditor; 2576 orë jashtë tij, 120 orë praktikë - ngarkesa mësimore javore 20 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi ka formën dhe strukturën e një programi tradicional bachelor në administrim biznesi. Lëndët që e përbëjnë programin mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 për sa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese. Lëndë ndërdisiplinore dhe Detyrime përmbyllesë. Nga pikëpamja e përmbajtjes evidentohet është një <u>peshë pak më e madhe e lëndëve të natyrës biznes</u>, evidentohet gjithashtu <u>mungesa e disa lëndëve që zhvillohen në BA dhe prania e disa lëndëve që në një pjesë të shkollave të biznesit bëhen në master</u>, këtu zhvillohen në BA. <u>Vihet re që mungojnë disa lëndë si Psikologjia, Sjellja konsumatore, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Media sociale dhe Marketingu digjital, si dhe shumë e rëndësishme impaktimi programit me AI dhe teknologji digjitale dhe brenda silabuseve.</u> <u>Programi do të duhet të rishikohet në disa element pas procesit të akreditimit, për të cilën GVJ u dakordësua dhe me stafin e programit gjatë vizitës në institucion ndërkohë që brenda silabuseve, literaturës, metodologjive ka hapësirë për përmirësime e ndryshime nga viti në vit.</u> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

	<i>Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit Bsc në AB, programi është organizuar si më poshtë: - Kategoria A – Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 30 ECTS ose 17 %, <i>standardi (13-20%)</i> - Kategoria B – Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 99 ECTS ose 55%, <i>standardi (50-55%)</i> - Kategoria C–Lëndë ndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 21 ECTS ose 12 %, <i>standardi (12-15%)</i> - Kategoria D – Lëndë plotësuese–gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 24 ECTS ose 13%, <i>standardi (10-15%)</i> - Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3 %, <i>standardi (3-5%)</i> <i>Studentët e programit Bachelor në Administrim Biznesi marrin 10 lëndë gjatë vitit të parë, 10 lëndë në vitin e dytë, dhe në vitin e tretë 9 lëndë, plus Praktikën Mësimore dhe Projektin e Diplomës.</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi 12: Strategjia e zhvillimit të Programit të Studimit</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Praktika profesionale është 6 ECTS në programin e studimit Bsc në AB. Gjatë vizitës në institucion, diskutuam për mënyrën si organizohet praktika. Organizimi praktikës mbështetet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në silabus, por Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit do të <u>duhet të hartojë Rregulloren e Praktikës Mësimore dhe tërësinë e dokumentave të praktikës.</u> Në lidhje me Detyrimet Përmbyllëse, ato organizohen në formën e një provimi përfundimtar dhe për studentët me mesatare mbi 7.5 punim diplome. Detyrimet përmbyllëse janë 6 ECTS pesha ne kurrikul është 3 %, standardi (3-5%) sipas VKM 41/2018. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<u>Ndonëse në RVB për këtë kriter GVB shprehet se nuk aplikohet, mendojmë që Departamenti do të duhet të ketë ngjashmëri në programin BA në AB me shkolla të tjera, brenda vendit apo jashtë. GVJ, sugjeron që kjo do të duhet të jetë pjesë e diskutimeve në department për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit që ata ofrojnë.</u> Dokumenti: RVB BA administrim biznes			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në VKM Nr. 310, dt 11.05.2022 për specifikimet dhe kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, si dhe në udhëzimet e MAS, kodi i programit Bsc në AB është bërë, dhe mbi bazën dhe të një përvojë të brendshme janë kodifikuar dhe lëndët.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	GVJ vlerëson që organizimi i programit bëhet në përputhje me ligjin nga pikëpamja e formës. Nevojiten disa përmirësime në strukturën e lëndëve që e përbëjnë këtë program, gjithashtu dhe rishikimi i planit mësimor për të plotësuar 4500 orët dhe raportin leksion seminar. Gjithashtu, duhet plotësuar dokumentacioni praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																							
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi Bsc në “Administrim Biznesi” është licensuar me VKM Nr. 429. Dt.18/07/2022 dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vitin 2022-2023, aktualisht është në vitin e tretë të tij dhe përmes këtij procesi po kalon akreditimin e parë. Njësitë kryesore në POLIS dhe në veçanti Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban përmbushin detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë (gjithsej 2 Departamente dhe një Qendër), dhe numrin e pedagogëve dhe gradat/titujt në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” . Fakulteti ka në përbërje njësitë bazë: 1. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë 2. Departamenti Planifikim dhe Mjedis 3. Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit Fakulteti Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban në vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 51 pedagogë, nga të cilët 28 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 23 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>16</td><td>10</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td>11</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>28</td><td>23</td></tr></table>				Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban		PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	Prof.Asoc	2	1	Dr/PhD	16	10	Msc	4	11	Gjithsej	28	23
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban																							
	PAE	PAK																						
Prof.Dr	1	1																						
Prof.Asoc	2	1																						
Dr/PhD	16	10																						
Msc	4	11																						
Gjithsej	28	23																						
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike: <table><tr><th>Tituj/ grada</th><th>2022-2023</th><th>2023-2024</th><th>2024-2025</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>				Tituj/ grada	2022-2023	2023-2024	2024-2025																
Tituj/ grada	2022-2023	2023-2024	2024-2025																					

	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	1	1	1	-	1
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	1
Dr./PhD.	9	4	10	6	10	4
Msc.	4	12	1	7	-	9
Totali	17	17	14	14	12	15

Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit mbajnë titullin akademik "Profesor i Asociuar"

Për sa më sipër Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;
- organizimin dhe strukturën akademike;

Sugjerohet organizimin sipas grup-lëndëve në përputhje me ligjin dhe rregulloren e fakultetit.

Dokumenti Aneksi 10. Organigrama e Universitetit POLIS
Dokumenti: RVB BA administrim biznes
Dokumenti Aneksi 39: Të dhënat tabelore Ascal

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e U. POLIS, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit parashikojnë koordinatorin e programit që mund të jetë përgjegjësi i departamentit ose një anëtar i tij, të paktën me gradën "Doktor". Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit ka një koordinatör të programit Bsc që mban gradën Doktor, të emëruar në kuadër të një vendimit të Rektorit të POLIS për të gjitha programet e studimit.

Dokumenti Aneksi 11: Vendimi Rektorit për koordinatörët e programeve
Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB
Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme
Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit

Konkluzione

GVJ vlerëson që njësia kryesore dhe njësia bazë – Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, përmbushin kërkesat ligjore në lidhje me nr departamenteve dhe stafin akademik në to. Sugjerohet formimi grup-lëndëve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi Bsc në AB i ofruar nga POLIS, është shfaqur në ofertën akademike të universitetit si një nevojë për të plotësuar programin fillestar MP në AB. Drejtuesit e fakultetit dhe zv.rektorja për cilësinë shprehen që BA në AB reflekton qasjen ndërdisiplinare POLIS. Megjithatë që vizitës në institucion dhe diskutimin me stafin akademik të programit GVJ u dakordësua me ta që sot dinamikat e punësimit të studentëve janë të tilla që ata synojnë formim dhe aftësim në nivel lokal dhe global dhe përmbajtja e programit duhet të përshtatet me trendet e reja teknologjike, sociale dhe ekonomike. Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e silabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimi, kontrollit të njohurive, të ftuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale, por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të teksteve, metodave të mësimdhënies dhe mbi të gjitha formalizimit në silabus të tyre, impaktimit me AI dhe teknologjitë digjitale të përmbajtjes, etj. Në përvojën POLIS, siç stafi akademik dhe drejtuesit e fakultetit u shprehën gjatë vizitës, ka kontakte dhe eksperiencë me një sërë organizatash të rëndësishme në vend si dhe me institucione e bizneseve lokale. Në faqen zyrtare në internetit të POLIS, studentët njihen mbi dokumentat kryesore, planet dhe programet mësimore dhe shumë informacione të tjera në funksion të regjistrimeve dhe kalendarit akademik. <i>Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e	Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit është i strukturuar në 3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	vite studimi, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër. Ky program studimi është në përputhje me Sistemin e Bolonjës. Programi dhe Plan i mësimor i programit të studimit BA në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e POLIS dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <i>Lëndët janë kryesisht me 6 ECTS (vetëm dy prej tyre me 3 ECTS), ajo që bie në sy është një raport leksione/seminare që lëviz nga 24/36, në 36/24 dhe 48/12 logjika e të cilit mbeti e pashpjeguar bazuar në udhëzimet e MAS dhe në standardet e cilësisë. Ky është një element që duhet riparë me kujdes nga POLIS.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në AB është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 31, përfshirë praktikën dhe diplomën; - ngarkesa mësimore 4470 orë: 1774 orë në auditor; 2576 orë jashtë tij, 120 orë praktikë - ngarkesa mësimore javore rreth 20 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. Një element tjetër <u>objekt diskutimi</u> me stafin akademik ishte mënyra e kontrollit të njohurive, bazuar kryesisht në një skemë pjesëmarrje/angazhim/detyra/projekte dhe vlerësim përfundimtar, me një peshë ky i fundit nga 40 %– 60 %, por <u>ka dhe lëndë pa provim (analogjia me lëndët e programeve të arkitekturës nuk përbën argumentin e duhur).</u> <u>GVJ sugjeron reflektimin mbi mënyrën e kontrollit të njohurive në respekt të udhëzimeve dhe standardeve, lëndë të një tipologjie mund të unifikohen; krahas provimit final të vendoset dhe provimi ndërmjetës.</u> Në lidhje me silabuset e lëndëve, GVJ vlerëson që në pikëpamje të formës ato plotësojnë Udhëzimin 41/2018, <u>por mungon në një pjesë të tyre detajimi i temave, metodologjive për çdo temë dhe seminarit përkatës, faqet e literaturës, linqet, të ftuarit në auditor dhe forma</u>

	<u>të tjera të mësimdhënies, mungon dhe formati në anglisht. Gjithashtu, duhet rishikuar dhe literatura në një pjesë të tyre.</u> <u>Departamenti do të duhet të arkivojë dhe silabuset në gjuhën angleze.</u> Dokumenti: RVB BA administrim biznes Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike Dokumenti Aneksi 15: Plani mësimor Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit të studentëve në Programin BA në AB janë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik. POLIS në sistemin e tij të brendshëm të pranimit të studentëve organizon dhe një test pranimi. Në Rregulloren e POLIS dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi akreditohet për herë të parë dhe gjatë takimeve në institucion gjetëm përpos procedurave të brendshme dhe një përjasje të stafit e drejtuesve që me mbarimin e procesit të akreditimit do të reflektojnë mbi përmbajtjen e programit dhe të silabuseve, me një përjasje me kritike dhe analitike ndaj tyre dhe respektimit të udhëzimeve dhe standardeve. Gjithashtu, Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, duhet të bëjë një vlerësim nisur nga disa burime informacioni: - programeve të universiteteve perëndimore dhe ballkanike - nevojat e tregut të punës lokal dhe kombëtar - tryezave të rrumbullakta me alumni të MA, ekspertë dhe kolegë - fokus grupeve me studentë të BA dhe MA
Konkluzione	GVJ vlerëson dhe rekomandon rregullimin në numrin total të orëve të programit, rregullimin e raportit të orëve leksion/seminar; përshtatjen e programit me nevojat e tregut, rishikimi i tërësisë së lëndëve që ofrohen, futja e disa lëndëve të

	<i>domosdoshme si dhe të lëndëve që lidhen me zhvillimet e fundit teknologjike, AI përfshirë, zvogëlimi i peshës së lëndëve të biznesit, kalimi i disa lëndëve në MA dhe anasjelltas, formulimi i silabuseve në përputhje të plotë me VKM 41/2018, formulimi dhe në gjuhën angleze si dhe rishikimi i elementëve të kontrollit të dijës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër. Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit BA në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e POLIS dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në AB, programi është organizuar si më poshtë:
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	- Kategoria A – Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 30 ECTS ose 17 %, <i>standardi (13-20%)</i> - Kategoria B – Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 99 ECTS ose 55%, <i>standardi (50-55%)</i> - Kategoria C–Lëndë ndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 21 ECTS ose 12 %, <i>standardi (12-15%)</i> - Kategoria D – Lëndë plotësuese–gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 24 ECTS ose 13%, <i>standardi (10-15%)</i> - Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3 %, <i>standardi (3-5%)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Studentët e programit Bachelor në Administrim Biznesi marrin 10 lëndë gjatë vitit të parë, 10 lëndë në vitin e dytë, dhe në vitin e tretë 9 lëndë, plus Praktikën Mësimore dhe Projektin e Diplomës. <i>Lëndët janë kryesisht me 6 ECTS (vetëm dy prej tyre me 3 ECTS), duke patur ndryshime në numrin e orëve mësimore, dhe një raport leksione/seminare që lëviz nga 24/36, në 36/24 dhe 48/12.</i> Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në AB është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 31, përfshirë praktikën dhe diplomën; - ngarkesa mësimore 4470 orë: 1774 orë në auditor; 2576 orë jashtë tij, 120 orë praktikë - ngarkesa mësimore javore 20 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. Mbështetur në Rregulloren e Programit BA në AB, silabuset e lëndëve, evidentojmë që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërbejnë për të krijuar njohurinë dhe aftësuar studentëve në fushat bazë të biznesit, u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqasur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës. Ky program krijon një bazë të domosdoshme për studime të tjera e thellime në fusha më specifike të biznesit. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Plan mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë	Në vijimësi të këtij raporti, në lidhje me silabuset GVJ mbetet konstant në qëndrimin që përmbajtja e silabusit duhet përmirësuar, kështu që në mënyrë të përsëritur <u>GVJ rekomandon që:</u> - <u>të rishikohet raporti leksion/seminar</u> - <u>të shtjellohen temat,</u> - <u>të përcaktohet metodologjia e përdorur në çdo seminar,</u>

literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<u>- të vendoset literature bazë dhe e rekomanduar në çdo temë, të vendosen faqet apo linqet e literaturës, rasteve studimore, videove etj;</u> <u>- të paraqiten të ftuarit në auditor, vizitat në biznese, e forma të tjera të mësimdhënies e nxënies;</u> <u>- të rishikohet mënyra e vlerësimit.</u> <u>- të përditësohet literatura me literaturë të 5 viteve të fundit</u> <u>- të formulohen në anglisht silabuset</u> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e silabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin të mirë të studentëve nga pikëpamja njohurive dhe aftësimit praktik, për t'ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global. Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në raporte ndërveprimi me tregun e punës përmes orëve të hapura, Panairit të Punës, vizitave në biznese dhe konkurseve të mbështetura nga biznesi. Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t'u punësuar. POLIS dhe departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit mund të krijojnë oportunitete të shumta në raportet me bizneset, në projektet e përbashkta, ndërkombëtare dhe në përfshirjen e studentëve. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që struktura dhe organizimi është në përputhje me objektivat, përmbajtja është dhe duhet të jetë në një proces përmirësim dhe përditësimi në përputhje me zhvillimet në tregun e punës dhe qasjet e reja të shoqërisë. Mendojmë e sugjerojmë më shumë dinamikë në program</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Tregu i punës është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekspertëve të hartimit të programeve. Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit POLIS-industri, por ato kanë nevojë të bëhen më të qëndrueshme, në nivel departamenti. Programi Bsc në AB që po akreditohet karakterizohet nga rritja e numrit të studentëve, ndonëse në shumë universitete këto programe po tkurren, ky avantazh afatshkurtër do të duhet të vlerësohet dhe të shoqërohet me shumë dinamikë. Pozitive janë raportet e universitetit/departamentit/pedagogëve me organizatat/bizneset, por dhe shumë bashkëpunime të tjera ndërkombëtare – që përbëjnë dhe qasjen POLIS. Panairi i Punës, Konferencat dhe disa konkurse studentore, vizitat në biznes, praktikat mësimore, leksionet me të ftuar nga biznesi/institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Pozitiv është fakti që një pjesë e pedagogëve të jashtëm vinin nga eksperiencia biznesi, drejtimi institucionesh dhe organizatash me peshë, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes os departament-biznes. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhëna tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në tregun e punës i cili është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekspertëve të hartimit të programeve. Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit POLIS-industri, por ato kanë nevojë të bëhen më të qëndrueshme, në nivel departamenti. <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit</i>

Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, studentët janë pjesë e Senatit, NJSBC dhe GVB. Gjithashtu, në nivel institucioni, bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme. <u>GVJ sugjeron mbledhje periodike të departamentit me studentët, të cilat mund të planifikohen me tematika dhe grupe e nivele të ndryshme.</u> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët e vlerësimit të stafit akademik dhe administrativ</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se në mënyrë formale dhe joformale, studentët bëhen pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet dhe mënyra se si bashkëpunojnë me institucione, biznese dhe organizata të tjera dhe si ndikonin veprimtaritë e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.asc.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Mësimdhënia në Programin e Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti I Menaxhimit dhe Biznesit bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, rregulloren e Fakultetit si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 19 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde. <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhë nga kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Në mbështetje të një performace më të mirë mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. Institucioni ka si procedurë të detajuar vlerësimin e pedagogut të lëndës nga studentët, kolegët, dhe forma e vetëvlerësimit. Gjatë konsultimeve me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se çdo ankesë ose sugjerim e adresuar nga studentët ose kolegët merret parasysh për përmirësimin e mësimdhënies dhe përdorimin e formave të reja. <i>Dokumenti Aneks 30: CV e stafit akademik</i> <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 07: Marrëveshja me IPAG.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe	Bazuar në takimin me stafin e Departamentit rezulton se FPMMU i UP mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve

në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, menaxhimit të klasave, komunikimit, kërkimit shkencor, sistemit të dhënave, etj. <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Administrimit Biznesit dhe fusha të tjera të lidhura me të. Eksperienca në mësimdhënien e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përbën dhe realizimi i mësimin online gjatë situatës pandemike. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Vetë karakteri aplikativ i disa lëndëve, sidomos të modelimit dhe menaxhimit, rrisin pavarësinë e studentit në këtë proces. <i>Aneks 30_CV e stafit akademik</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Njëkohësisht NJSBC ndan me departamentin problematikën e dala nga anketimi i studentëve të cilat diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që	Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se tashmë janë miratuar dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e

promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit si njësi bazë e këtij programi. Departamenti ka të caktuar një koordinator të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në. Njëkohësisht edhe mobilitetet në institucionet partnere në kuadër të projektit ERASMUS + si dhe aktivitetet e organizuara nga departamenti apo fakulteti kanë mbështetur në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies, dhe zhvillimin e metodave të reja inovative. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 07: Marrëveshja me IPAG.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se nëpërmjet suportit administrativ të NJBSC-së, kualifikimeve dhe eksperiencën e stafit akademik, si dhe përfshirjen e stafit në trajnime dhe projekte ndërkombëtare, Universiteti POLIS garanton procesin e të nxënies dhe aftësimit profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UP), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban) dhe rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumenta janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>

	<i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet: • Informacionit të marrë në websaitin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në të; • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre. <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në forma tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde. <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Njekohesisht NJSBC ndan me departamentin problematikën e dalë nga anketimi i studentëve të cilat diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve si psh. në lëndën e Menaxhim Operacionesh.
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se tashmë janë miratuar dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti Menaxhimit dhe Biznesit si njësi bazë e këtij programi. Departamenti ka të caktuar një koordinator të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në. Njekohësisht edhe mobilitetet në institucionet partnere në kuadër të projektit ERASMUS + si dhe aktivitetet e organizuara nga departamenti apo fakulteti kanë mbështetur në funksion të

mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	përmirësimit të metodave të mësimdhënies, dhe zhvillimin e metodave të reja inovative.			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se Institucioni ka të gjitha strukturat e posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre nëpërmjet Rregullores së UP, Rregullores së Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, rregullores së këtij programi, si dhe Rregullores Didaktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët vlerësohen sipas disa kriterëve gjatë gjithë semestrit. Në përgjithësi, ekzistojnë dy korniza kohore të dedikuara për provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Studentëve u kërkohet të punojnë në raste studimore, të bëjnë projekte ose të bëjnë një prezantim sipas çdo lënde detyrat përkatëse siç përcaktohet në syllabusin e çdo lënde të ofruar në kurrikulën e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konfirmoi që IAL ka përdorur një sërë kriteresh të shtrira përgjatë gjithë semestrit të cilat reflektohen dhe në vlerësimin final. <i>Aneks 29 Syllabuset e programit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Njëkohësisht institucioni përdor programin Turnitin në lidhje me kontrollin e plagjiaturës në punimet e studenteve, proces që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së punimeve. <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i>

Handwritten signature

	<i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Testimi vlerësues për çdo lëndë ka specifikat dhe kërkesat e veta, detajet e të cilave gjenden në syllabuset përkatëse. Megjithëse shpërndarja e përqindjes së vlerësimit është e shpërndarë gjatë vitit dhe konkludohet me një provim përfundimtar që në përgjithësi mban peshën më të lartë të vlerësimit. <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë kryesore dhe bazë, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. Gjithashtu, institucioni ka program antiplagjaturë (Turnitin) që eidenton këtë mangësi për punimet e mikrotezave të studentit. Për të minimizuar këtë, nga takimi me stafin e departamentit, u evidentua rëndësia që i jepej punimit të mikrotezës, të bazuara në raste studimore. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Mbështetur në DVV, GVJ konstaton që çdo dorëzim detyre, provimi, ose mënyre tjetër vlerësimi është parashikuar me data përkatëse në fillim të semestrit dhe reflekton në data specifike në syllabus dhe kalendar akademik. Rezultati i çdo vlerësimi, sipas planprogramit lëndor, bëhet publik nga platforma e sistemit PITAGORA, nota/pikët e vlerësimit të dhëna në çdo vlerësim tregohen menjëherë dhe u dërgohen studentëve me e-mail, duke

	vënë në dispozicion një datë për të diskutuar dhe komentuar vlerësimin. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas rregullores didaktike të institucionit përcaktohet e drejta e studentit jo vetëm për tu njohur me vlerësimin por edhe për tu informuar më në thellësi për mënyrën se si është vlerësuar puna e tij. Në rast ankimimi nga ana e studentit, studenti ka të drejtë të kërkojë rishikimin e provimit nga ana e komisionit të vlerësimit. Nëse përsëri studenti nuk është i kënaqur nga vlerësimi, studenti ka të drejtë sipas rregullores të kërkojë ngritjen e një komisioni të pavaruar dhe rishqyrtimin e provimit. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast ankimimi nga ana e studentit, studenti ka të drejtë të kërkojë rishikimin e provimit nga ana e komisionit të vlerësimit. Nëse përsëri studenti nuk është i kënaqur nga vlerësimi, studenti ka të drejtë sipas rregullores të kërkojë ngritjen e një komisioni të pavaruar dhe rishqyrtimin e provimit. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti me anë të sistemeve antiplagjiaturë, dhe shpërndarjes të notës me vlerësime gjatë semestrit. Njëkohësisht, Institucioni ndjek procedura të posaçme në rast ankimim note dhe vlerësimi, të cilat mbështeten dhe në rregulloret përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Ky program studimi ka formën dhe strukturën e një programi tradicional bachelor në administrim biznes. Lëndët që e përbëjnë programin mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e menaxhimit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e aplikimeve të programeve në fushën e bizneseve, atë financiare, auditin apo modelimin e bizneseve dixhitale në praktikë. Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e menaxhimit për disa nga sektorët e ekonomisë. Modulet zhvillojnë aftësi të veçanta për një menaxher biznesesh që formohet me një bazë të shëndoshë analitike. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë me pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Gjithashtu, pedagogu i lëndës përkatëse, në fund të zhvillimit të mësimin, bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve. <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet	Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me administrim biznesin. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program. Stafi akademik që mbulon këtë program realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse.

dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim. <i>GVJ rekomandon që programi i studimit të ofrojë punë laboratorike për disa lëndë specifike në fushën e "Biznesit Dixhital", "Finances", duke mbështetur kështu rritjen e kapaciteteve dhe njohurive për këto lëndë.</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve ERASMUS, apo gjatë angazhimit në projekte. Mbështetur në vizitën në institucion evidentohet edhe realizimi i leksioneve të hapura me staf akademik të fushës apo specialistë të saj. <i>Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit BSC në "Administrim Biznesi" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet disa moduleve të cilat ndihmojnë në formimin e menaxhereve të kësaj fushe. Gjithashtu GVJ evidentoi kapacitetet e institucionit dhe stafit akademik në mbështetje të studenteve me përfshirjen e tyre në inkubatore biznesi dhe praktika profesionale. Krahas praktikave profesionale, GVJ rekomandon se programi i studimit duhet të ketë ndërthurje të praktikave laboratorike dhe platformave digjitale për realizimin e lëndëve të caktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

gn *72*

Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Studentët e këtij programi me mesatare mbi 8.5 pas përmbylljes së gjithë lëndëve të Vitit të 3, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi “Teze dhe Projekt Diplome (Project Proposal)”. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të UP dhe rregulloren e Diplomimit. Ky proces është me i detajuar në rregulloren e Diplomimit. Në këtë rregullore jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të Tezës dhe Projektit të Diplomës, ndjekjes së pedagogëve udhëheqës, mënyrës së mbrojtjes dhe dorëzimit. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Për studentët që plotësojnë kriteret për zhvillimin e temës së diplomës, punimi është i pavarur dhe krijues dhe synon të vërtetojë fitimin e aftësive dhe të kompetencave profesionale ose të njohurive të parashikuara. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Detajet gjenden në dokumentin “Rregulloren e Diplomimit”. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se PS ka vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në funksion të udhëheqjes provimit final të studentëve, personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Detajet gjenden në dokumentin “Rregulloren e Diplomimit”. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se PS ka vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i>

	<i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Tezës dhe Projektit të Diplomimit gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Nga takimi me studentët të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruar. Në rastin e punimeve të Tezës dhe Projektit të Diplomimit për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zerë një peshë të konsiderueshme. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes	Komisioni i pavarur nga procesi i përpilimit të diplomës në vazhdim, vlerëson studentin nëpërmjet notimit në përputhje me rregulloren e diplomimit, sipas së cilës mentori e vlerëson studentin Vlerësimi përfundimtar i diplomës së studentit kryhet nëpërmjet Në përfundim të provimit

së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	final, studenti vlerësohet me notë nga komisioni dhe rezultati shpallet në sistemin informativ të universitetit. Ndërkohë që punimi i diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga jo më pak se 3 anëtarë. Komisioni caktohet ose ndryshohet me vendim të Dekanit, në bazë të propozimit të Përgjegjësit të Departamentit. <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. Gjithashtu, pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit sapo ai bën edhe kërkesën përkatëse. <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit (PITAGORA).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka një procedurë të rregullt për mbrojtjen përfundimtare të përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të UP dhe rregulloren e Diplomimit, ku dhe gjenden detajet lidhur me strukturën e punimit të Tezës dhe Projektit të Diplomës, provimit përfundimtar dhe ndjekjes së pedagogëve udhëheqës, mënyrës së mbrojtjes dhe dorëzimit. Njëkohësisht Rregullorja përkatëse ka parashikuar dhe një proces rigoroz me një Komision të pavarur nga procesi i përpilimit të diplomës në vazhdim, i cili vlerëson studentin nëpërmjet notimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) ku specifikohet informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se UP ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër.																																																
	Të dhënt e paraqitura mëposht për Programin e Studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:																																																
	<table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td></td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>11</td><td>3</td><td>11</td><td>3</td><td>12</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>-</td><td>3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>15</td><td>6</td><td>15</td><td>6</td><td>15</td><td>6</td></tr></table>	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	1	1	1	1	1	Prof. Asoc.	2	-	2		2	1	Dr./PhD.	11	3	11	3	12	1	Msc.	1	2	2	2	-	3	Totali	15	6	15	6	15	6
	Tituj/ grada		2022-2023		2023-2024		2024-2025																																										
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																										
Prof.Dr.	1	1	1	1	1	1																																											
Prof. Asoc.	2	-	2		2	1																																											
Dr./PhD.	11	3	11	3	12	1																																											
Msc.	1	2	2	2	-	3																																											
Totali	15	6	15	6	15	6																																											
	Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” .																																																
	Për sa më sipër Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:																																																
	- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;																																																
	- organizimin dhe strukturën akademike;																																																

	<i>Dokumenti Aneksi 10. Organigrama e Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhënat tabelore Ascal</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në të dhënat e përcjella nga UP, mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë paraqitet si në vijim: - Në vitin akademik 2022-2023: 71% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 39% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK; Për sa më lart, konstatohet se <i>ngarkesa mësimore mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit. GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik me grade shkencore kanë një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ konstaton në IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master është shumë e rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel i cili është prej vitesh pjesë e Universitetit Polis, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Kontratat e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme hartohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. <i>Aneks 30_CV-te e stafit te angazhuar ne program</i> <i>Aneks 50_Model kontrate PAK/PAE</i> <i>Aneks shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme siç u verifikua nga tabelat e të dhënave. Procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza,

duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidaturave, kriteret që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen tek rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ u kërkuar të shikohej e verifikohesh procedura për rekrutimet më të fundit dhe dokumentacioni që ka shoqëruar procesin dhe u konstatua se në dosjet respektive ishin ruajtur dokumentat e kërkuara. <i>Aneks 51 _Formular për shpalljen e vendit vakant</i> <i>Aneks 52 _Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës _Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, ka në përbërje të tij edhe staf ndihmës akademik, të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e laboratorëve. Gjatë orëve të laboratorit, stafi akademik përgjegjës për lëndët në të cilat do të zhvillohen laboratorët, do të kryejnë laboratorët në prezencë të stafit ndihmës akademik, i cili asiston në mbarëvajtjen e këtij procesi. <i>Aneks 30 _ CV-te e stafit të angazhuar në program</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës _Tabelat përmbledhëse</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në	UP ka në strukturën e tij edhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ të punësuar. Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet

përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	dokumentacioni i nevojshëm dhe i gjithë dokumentacioni është i përfshirë në një dosje të vetme. GVJ u informua se të dhënat përditësohen periodikisht në fillim të vitit akademik ose atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. shtimi i ndonjë gradë shkencore ose titulli akademik, etj. <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me grupe interesi dhe partnerë si në fushën e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me subjekte private dhe shtetërore. Institucioni si edhe subjekti pritës për praktikën firmos kontratën e praktikës në të cilën përcaktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet mes palëve. Subjekti pritës e udhëzon dhe e angazhon studentin gjatë periudhës së praktikës në detyra të ndryshme që lidhen me objektivat e formimit të programit të studimit, duke patur gjithmonë një person (punonjës të kompanisë) i cili mbikëqyr dhe udhëzon studentin. Punimi i diplomës kryhet nga studenti duke patur udhëheqës staf akademik të UP me grada dhe tituj duke respektuar ligjet në fuqi sikurse edhe rregulloret përkatëse të Institucionit dhe të programit të studimit. <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Subjekti pritës, për praktikën profesionale të studentit, përcakton një person përgjegjës i cili duhet të udhëzojë studentin në të gjitha detyrat që ai duhet të kryejë. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit relacionin e praktikës, të cilën më pas e prezanton para komisionit të ngritur në nivel departamenti. Pas përfundimit të praktikës, studenti dorëzon relacionin e praktikës shoqëruar me një formular vlerësimi për të të bërë nga subjekti në të cilën është kryer praktika profesionale. <i>Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në këtë program studimi të ciklit të parë Bachelor është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me tituj dhe grada shkencore, si dhe ngarkesa</i>

	mësimore mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv, sikurse kërkohet nga parashikimet ligjore në fuqi. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është personel i cili është prej vitesh pjesë e Universitetit Polis, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, si dhe Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar. Institucioni ka marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani në kuadër të realizimit të praktikës profesionale, punimit të diplomës apo veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit dhe vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UP e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, sallë interneti, sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj. <i>Aneks 28 Planimetria dhe sipërfaqet</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e UP</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura	Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV, GVJ konstatoi se ambientet mësimore në POLIS ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti

me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike. <i>Aneks 28_Planimetria dhe sipërfaqet Vizita në institucion, ambjentet e UP</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike. Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. <i>Aneks 28_Planimetria dhe sipërfaqet Vizita në institucion, ambjentet e UP</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GJV konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratorëve nuk është i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor (godina 24 ore e hapur), por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit. <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit dhe vizita në ambjentet e UP .</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Polis e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në Institucion, nga takimet me stafin akademik, evidenton se literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përdorur është literaturë e viteve të fundit dhe garanton përcjelljen në mënyrë efektive të dijeve dhe njohurive tek studentët e këtij programi studimi. <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse viti 2024-2025</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të programit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni referohet se në bibliotekën online JSTOR, ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 85.000 tituj librash. Ky fond librash, bashkë me ato që ofron Edëard Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve pa pagesë, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit. Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Universiteti Polis zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu është në dispozicion të studentëve një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni referohet se në bibliotekën online JSTOR, ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 85.000 tituj librash. Ky fond librash, bashkë me ato që ofron Edëard Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve pa pagesë, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit. Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Universiteti Polis zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu është në dispozicion të studentëve një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë, ndaj <i>sugjerohet shtimi i kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.</i> Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u njoh me ambientet e bibliotekës dhe procedurat e përdorimit të saj nga ana e studentëve. Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore në gjuhën shqipe të hartuar

	nga pedagogë të këtij universiteti si edhe nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. UP ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Studentëve u mundësohet dhe akses në Bibliotekën Dixhitale EBSCO. Gjatë vizitës në sallën e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim akses në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të Universitetit. <i>www.universitetipolis.edu.al/biblo_polis</i> <i>Vizita në Institucion, ambientet e IAL</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Universiteti Polis zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu është në dispozicion të studentëve një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë, ndaj <i>sugjerohet shtimi i kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në sallën e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim akses në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të Universitetit.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë, ndaj <i>sugjerohet shtimi i kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret	Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Orari i funksionimit të bibliotekës është nga e hëna në të premte në orarin 08:30-16:30 dhe në fundjavë në orarin 09:00-17:00 gjatë ndjekjes së programeve master. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Master Shkencor dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.			
	<i>Vizita në institucion, biblioteka</i>			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, në kuadër edhe të projekteve në të cilat ka marrë pjesë, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.			
	<i>Vizita në institucion, biblioteka</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universitetit POLIS zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Gjithashtu ky institucion ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra fizik dhe biblioteka online.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni menaxhon të dhënat e tij përmes platformës Pitagora. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin dhe me emailin institucionale. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Regjistrimit të arritjeve akademike dhe Regjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm Pitagora disponon informacion edhe mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ. Ky informacion i shërben zyrës juridike të depozitojë një dosje të veçantë për gjithë personelin, si dhe krijon një lidhje ndërmjet sekretarisë mësimore, pedagogut dhe fakultetit. Sistemi u mundëson informacion studentëve, personelit akademik dhe atij administrativ, zyrave të ndryshme në institucion. Studentëve u mundëson informacion lidhur me planprogramin e lëndës, vlerësimet e tyre, etj.; personelit akademik u mundëson informacion mbi statusin e studentit, rezultatet akademike të studentit, etj.; Zyra e Financës gjurmon tarifën e studimit të studentëve, etj.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajisen me adresë email-i personale me anë të së cilës komunikojnë në vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrativ, etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre por gjithashtu edhe nëpërmjet platformave të ndryshme si psh. Teams, për hedhjen e materiale apo leksioneve të ndryshme. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit	Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, ky Fakultet gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe ZOOM janë zhvilluar seanca mësimore gjatë

ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektësh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi dhe studentët janë të pajisur me adresa email-i zyrtare të formatit contact@universitetipolis.edu.al duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të Universitetit Polis, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit, jepet informacion për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj. <i>GVJ eksploroit mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</i> <i>Website: https://universitetipolis.edu.al/</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<i>Universiteti Polis disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i> <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i> <i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të Universitetit Polis, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i>			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet në nivel institucioni nga Administratori dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatën Akademik dhe Rektoren e Universitetit Polis. Buxheti i alokohet sipas Njësive Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. GVJ konstatoi se nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në Statut përcaktohet se veprimtaria e Universitetit Polis financohet nga : a) pagesat e studentëve për arsimim; b) të ardhurat për shërbimet e kryera; c) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; d) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; e) veprimtari kërkimore-shkencore; f) projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial administrativ i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Universitetit Polis. Me propozim të Senatit Akademik ai miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm si edhe garanton zbatimin e tij. Ai përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që sigurohen nga ushtrimi i veprimtarisë si edhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit. Akti më i rëndësishëm në lidhje me aspektet e menaxhimit të institucionit është miratimi i Buxhetit të institucionit. GVJ konstatoi se procesi i hartimit të projekt buxhetit është gjithpërfshirës dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Çdo vit, pasqyrat financiare të Institucionit i nënshtrohen auditimit nga një kompani ndërkombëtare, e cila konfirmon vërtetësinë dhe pasqyrimin e drejtë të informacionit financiar. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i>




Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Universiteti Polis paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Zyra e Financës është përgjegjëse për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet afatmesme dhe ato synojnë garantimin e mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 10. Organigrama e Universitetit POLIS</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti Polis dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 10. Organigrama e Universitetit POLIS</i>			
Konkluzione	Universiteti Polis dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	--------------------------------

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimit BA në Administrim-Biznes 180 ECTS është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si: - Statuti Universiteti POLIS; - Rregullorja e përgjithshme POLIS; - Rregullorja didaktike; - Rregullorja e Fakultetit - Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznes; - Rregullorja e Kodit të Etikës Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësive kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin BA, deri në diplomimin e tyre. Departamenti si rregull propozon tek Dekani kriteret e pranimit të studentëve në BA në AB, nisur nga kriteret ligjore, i vetmi kriter shtesë është testi i pranimit. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Rregullore e Kodit të Etikës</i>

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit BA në AB, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e Etikës, etj. Studentët gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për Senatin Studentor. Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në aktivitete e seminare extracurriculare, etj. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Rregullore e Kodit të Etikës</i> <i>Dokumenti Aneksi 58: Statuti senatit studentor</i> <i>Dokumenti Aneksi 59: Struktura e senatit studentor</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Universiteti POLIS bën të aksesueshme në faqen zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset. Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, regjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në site gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përshirë dhe email e kontaktit të drejtuesve. Në këtë link të https://universitetipolis.edu.al/# studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe përmbajtjen e programit https://universitetipolis.edu.al/administrim-biznesi/ dhe tarifat e shkollimit në linkun https://universitetipolis.edu.al/tarif-e-studimeve-bachelor/.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të	Programin e studimit e gjejmë në linkun pasues https://universitetipolis.edu.al/administrim-biznesi/, në linkun tjetër stafin akademik të angazhuar në program https://universitetipolis.edu.al/fakultetet-stafi/fpmu-staff/

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Dokumentat strategjike, ligjorë e rregullatorë i gjejnë në linkun https://universitetipolis.edu.al/akreditimi/; https://universitetipolis.edu.al/akte-normative/ dhe raportet e transparencës dhe të veprimtarisë vjetore në https://universitetipolis.edu.al/transparenca/ Në orën e parë të mësimit të çdo lëndë apo moduli, qartësohen të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve, ndërkohë sekretaria mësimore informon studentët për çështje proceduriale. Gjithashtu, përmes sistemit Pitagora të garantuar nga RASH, studentët kanë mundësi të informohen për ecurinë e tyre në procesin mësimor. Gjatë takimit në institucion me përfaqësuesit e Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, ato u shprehën se janë shumë aktivë në median sociale, duke informuar përmes disa postimeve në ditë, të cilat intensifikohen në periudhën e rekrutimit të studentëve të rinj. Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studiojnë në POLIS është Broshura POLIS. Gjithashtu, universiteti bëhet pjesë çdo vit e Panairit “Work and Study”, ndërkohë që organizon evente të shumta për maturantët. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 47: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Rregullore e Kodit të Etikës</i> <i>Dokumenti Aneksi 54: Broshura Polis</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregullore e ZMSKK</i> <i>Dokumenti Aneksi 56: Programi i Panairit të Karrierës 2024</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Bazuar në udhëzimin Nr. 17 dt. 30.07.2019, si dhe në përvojën e krijuar në vite, departamenti përcakton kuotat për studentët me aftësi ndryshe, ata që vijnë nga pakicat dhe shtresat në vështirësi. Në përputhje me udhëzimet e MAS, por dhe traditën e krijuar me regjistrimet vit pas viti, departamenti vlerëson kuotat sipas kategorive të përcaktuara nga Matura Shtetërore, përfshirë dhe studentët që vijnë nga trojet shqiptarë, propozimet kalojnë në dekanat dhe miratohen nga senati akademik, për t’u përcjellë për fazën e fundit të miratimit tek Bordi Administrimit brnda IAL-së. Në lidhje me aplikantë nga vende të tjera ende programi i studimit Për tarifat e shkollimit informacioni merret përmes linkut https://universitetipolis.edu.al/tarifat-e-studimeve-bachelor/, ndërsa linku pasues shërben për informimin mbi bursat e

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	akorduara nga POLIS https://universitetipolis.edu.al/bursa-studimi/ . POLIS ofron bursa ekselence, sociale dhe talenti, gjatë takimit me studentët e programit evidentuam që kishte mes tyre studentët që kishin përfituar burse ekselene bazuar në mesataren e shkollës së mesme dhe ruajtjen e saj nga viti në vit, studentë që kishin fituar bursë nga konkurse të ndryshme dhe bursë familjare, për shkak të studimit të dy personave nga familja. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 17: Vendim mbi kuotat e pranimi</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, POLIS vepron në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe të gjitha VKM apo udhëzimet që vit pas viti përditësohen në përputhje me ndryshimet që bëhen në Maturën Shtetërore apo vendimeve në mbështetje të studentëve dhe shkollimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në Rregulloren Didaktike dhe në Rregulloren e Programit BA në AB pasqyrohen procedurat e përparimit akademik. Gjithashtu në përmbajtjen e silabusit të lëndës përcaktohen elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve dhe pesha që zë provimi përfundimtar. Studenti është kalues nëse ai ka mbledhur 45 pikë në vlerësimin e vazhduar dhe në provimin përfundimtar, sipas Rregullore së Programit. Sezonet e provimit, janë në fund të semestrit të parë dhe të dytë, përmes sistemit Pitagora studentët informohen për ecurinë e tyre akademike, pas çdo sezoni provimi.
	<i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse 2024-2025</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit	Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë nga pedagogu në orën e parë të çdo lënde/moduli, në faqen e internetit ku gjen të gjitha rregulloret kryesore, përmes sekretarisë mësimore, medias sociale dhe faqes së internetit si dhe përmes sistemit të email të intranetit të POLIS. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse 2024-2025</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. POLIS bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në dokumentat kryesorë rregullatorë të tij ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Në Rregulloren Didaktike të POLIS në Kreun X të emërtuar “Transferimet, Njohja e Krediteve dhe Ekuivalentimet i Lëndëve përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi. Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren Didaktike, Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Si detyrim përmbyllës i programit mësimor - gjithsej 6 ECTS, alternativat janë përmes provimit përfundimtar dhe punimit të tezës së diplomës, kjo e fundit për studentët që kanë mesatare mbi 7.5. Për punimin e diplomës është miratuar një rregullore diplomimi. Në semestrin e 6 të studimeve në POLIS, ditën e hënë në një orar të caktuar studentët bëjnë takime dhe konsultime me pedagogët sipas një kalendarit të caktuar lëndësh e temash Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Për të gjitha momentet kryesore të këtij detyrimi,



	studentët njoftohen në klasë, në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit. <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 21: Rregullore diplomimi</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Ka disa rrugë të informimit të aplikantëve për studimet BA në AB,: - E para përmes faqja zyrtare e POLIS në internet, medias sociale, bazuar në politika të caktuara të marketingut që universiteti ka; - Së dyti, përmes Ditëve të hapura, pjesëmarrjes në Panairin “Work and Study”, aktiviteteve me gjimnaze, konkurseve të talenteve, etj - Zyrës së Mbështetjes së Studentëve de Këshillimit të Karrierës; e cila ka një vemendje të lartë në institucion për shkak dhe të faktit që institucioni është jopublik; - Broshurës së universitetit POLIS; - Word of mouth, takimeve me drejtues e pedagogë të fakultetit. <i>Dokumenti Aneksi 54: Broshura Polis</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregullore e ZMSKK</i> <i>Dokumenti Aneksi 56: Programi i Panairit të Karrierës 2024</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se POLIS ka një veprimtari shumë intensive në funksion të studentëve në lidhje me dhënien e informacionit mbi programin e studimit, përmes formave që sot aksesohen më shumë nga të rinjtë Gjithashtu dhe brenda fakultetit janë ndërtuar mekanizmat që informacioni për çdo fazë të jetës akademike të shkojë në mënyrë sa më të shpejtë tek studentët. Media sociale, faqja e internetit dhe platforma Pitagora e mundësojnë këtë gjë..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	POLIS ka bërë përpjekje për të ngritur sistemin për informimin e studentëve dhe të interesuarve për studentë dhe të familjarëve të tyre për programet e studimit, organizimin dhe rregullat bazë të

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	funksionimit, si dhe të gjithë mundësinë që institucioni krijon për karrierën e tyre. Studentët aktualë dhe të ardhshëm informohen përmes disa mundësive: - Faqja zyrtare e POLIS në internet https://universitetipolis.edu.al/ - Media sociale e universitetit - Veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës - Materialeve promovuese Broshura POLIS fletëpalosje, etj - Ditëve të hapura – ku roli i Departamentit në qartësimin e strukturës së programit është shumë i rëndësishëm, por dhe zyrat administrative, përfshirë Sekretarinë Mësimore luajnë një rol rëndësishëm në plotësimin e të gjithë elementëve që studenti ka interes. Gjithashtu, qartësohen dhe të gjitha zyrat e tjera të cilat janë në shërbim të studentit, financa, IT, karriera, etj - Javën e parë të mësimit nga çdo pedagog, i cili qartëson të gjithë elementët e silabusit; - Koordinatorës së programit; - Këshilluesit akademik; - Pitagora, platformës së menaxhimit të të dhënave për ecurinë akademike, të cilën studenti mund ta aksesojë dhe jashtë kampusit. - Email zyrtar të studentit në POLIS, me të cilin pajiset në momentin e regjistrimit dhe të nënshkrimit të kontratës; - Stendave informative në ambjentet e universitetit <i>Dokumenti Aneksi 54: Broshura Polis</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregullore e ZMSKK</i> <i>Dokumenti Aneksi 56: Programi i Panairit të Karrierës 2024</i> <i>Dokumenti Aneksi 53: Silabuse 2024-2025</i> <i>Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëse flitet për një nga pikat e forta të POLIS, në vite është kthyer në një pikë të rëndësishme referimi për ndërkombëtarizimin, punën me projekte dhe misionin e tretë si dhe punësimin e studentëve. Pedagogët e departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit për shkak të network-ut të tyre, luajnë një rol të rëndësishëm në ftesat në auditor të sipërmarrësve dhe ekspertëve të biznesit, në organizimin e praktikës mësimore, në organizimin e Panairit të punës dhe të një sërë eventesh në Fakultet/Universitet.

	Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve në lidhje me këtë kriter të standardit, veçuar angazhimin e Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. (https://universitetipolis.edu.al/karriera-studentore-eventet/) <i>Dokumenti Aneksi 56: Programi i Panairit të Karrierës 2024</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregulore e funksionimit të ZMSKK</i> <i>Dokumenti Aneksi 57: Lista e kompanive pjesëmarrëse në Panairin e Karrierës</i> <i>Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në POLIS ekziston sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentit PITAGORA (të ecurisë akademike), por mungon Learning Management system.			
Konkluzione	GVJ vlerëson që aktualisht POLIS ofron informacion të plotë mbi strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, ndërkohë që sfidat lokale dhe globale shtrojnë nevojën për rrugë e instrumenta të reja, në përputhje me gjeneratën Z dhe sfidat që tregu i punës po kalon.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.RRe

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e POLIS, Sekretaria Mësimore, funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, <u>sugjerojmë formulimin e rregullores së sekretarisë mësimore</u>; Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Programi bachelor në administrim biznes me akreditohet për herë të parë, në tabelën më poshtë jepet një statistikë e numrit të studentëve. <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nota mesatare</th><th>Çrregjistri me/transferime</th><th>Totali</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>15</td><td>8</td><td></td><td>15</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>17</td><td>7.9</td><td></td><td>17</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>33</td><td>8.3</td><td></td><td>33</td></tr><tr><td>Totali</td><td colspan="4">65</td></tr></table> <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhënat tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nota mesatare	Çrregjistri me/transferime	Totali	2022-2023	15	8		15	2023-2024	17	7.9		17	2024-2025	33	8.3		33	Totali	65			
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nota mesatare	Çrregjistri me/transferime	Totali																						
2022-2023	15	8		15																						
2023-2024	17	7.9		17																						
2024-2025	33	8.3		33																						
Totali	65																									
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë mësimore. Dosjet e ecursisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, rregjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike në Pitagora. Përmes të dhënave të marra nga sekretaria, si rregull drejtuesit e departamentit hartojnë një raport analitik të detajuar mbi procesin mësimor dhe statistikën e studentëve, në fakt në dosjen e programit të studimit nuk e gjetëm një dokumenti të tillë. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 39: Të dhënat tabelore Ascal</i> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>																									
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve, PITAGORA funksionon me akses vetën në marrjen e informacionit për studentët, ndërkohë pedagogët aksesojnë të dhënat e lëndëve të tyre, ndërkohë sekretaria mësimore hedh të dhënat, verifikon dhe prodhon proces verbale e material të tjera. Elementët e sigurisë përcaktojnë dhe aksesin e punonjësve të sekretarisë, pedagogëve dhe studentëve. Sistemi Pitagora menaxhohet nga RASH në bashkëpunim me universitetet.																									

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Garantimi i cilësisë së menaxhimit të sistemit të administrimit të të dhënave, është konsiderohet nga drejtimi i lartë si një nga elementët e procesit të auditimit. Për këtë arsye, bazuar dhe në legjislacionin në fuqi dhe në strukturat e brendshme, Në Planin e Veprimit dhe Qëndrueshmërisë për Politikën e Sigurimit të Cilësisë gjejmë elementë të këtij procesi, megjithatë në dosjen e dokumentave të paraqitur, nuk gjejmë vetëm një raport auditimi për sekretarinë mësimore. <i>GVJ sugjeron një frekuencë të paktën vjetore, në drejtim të auditimit të sekretarisë dhe dokumentimi përmes një raporti.</i> <i>Dokumenti Aneksi 64: Plani i Veprimit dhe Qëndrueshmërisë</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se ky standard plotësohet kryesisht, duke konstatuar mësipër në gjetjet, duhet hartuar rregullorja e sekretarisë, formuluar raporti vjetor analitik nga drejtuesi departamentit dhe audituar sekretaria të paktën një here në vit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. <i>Kreu X</i> i Statutit të POLIS i dedikohet studentëve, në Nenin 62 - Të drejtat dhe detyrimet e studentëve- përcaktohet që studentët gjatë periudhës së studimeve kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin e Universitetit, në raportet që përcakton ligji, ku përfaqësuesit e studentëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. Gjithashtu, studentët janë pjesë e: - Njesisë të sigurimit të standardeve të cilësisë; - Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët; - Grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.asc.al

rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë <i>Senati Studentor</i> e cila mbron dhe përfaqëson interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit. Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit si: Rregullorja e POLIS; Rregullore për Senatit Studentor; NJSBC në rang fakulteti, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. Pjesëmarrja e studentëve në komisione, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimit e programeve, programin BA në Ab përfshirë. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. <i>Dokumenti: RVB BA administrim biznes</i> <i>Dokumenti Aneksi 03: Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 58: Statuti senatit studentor</i> <i>Dokumenti Aneksi 59: Struktura e senatit studentot</i> <i>Dokumenti Aneksi 60: Përfaqësia studentore</i> <i>Dokumenti Aneksi 28: Kalendar i takimeve me Senatin Studentor</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Studentët përfshihen në mënyrë direkte dhe indirekte në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kështu, ata bëjnë vlerësimin periodik të mësimdhënies së pedagogëve, ndërveprojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, ndërveprojnë dhe orientojnë pakënaqësitë apo sugjerimet e tyre përmes pjesëmarrjes në shumë komisione e organe, dhe natyrisht sjellin zërin e tyre përmes Senatit Studentor. <i>Dokumenti Aneksi 05: Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 28: Kalendar i takimeve me Senatin Studentor</i>

Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të drejtë të kërkojnë shpjegim për mënyrën e vlerësimit të dijeve në të gjitha format e kontrollit të dijes, nga pedagogu i tyre. Në rastin kur shpjegimi i pedagogut nuk është shterues për arsyet që studenti mbron, ai gëzon të drejtën e ankimimit në Sekretarinë Mësimore. Në Rrefulloren Didaktike dhe atë të Programit të Studimit qartësohen procedurat dhe hapat në rast të pranimi apo jo të ankesës nga pedagogu. Studentët e njihnin procedurën por deri më tani, nuk e kishin aplikuar. <i>Dokumenti Aneksi 04: Rregullore e Programit AB</i> <i>Dokumenti Aneksi 15: Rregullore didaktike</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që nga pikëpamja e zbatimit të ligjeve dhe akteve rregullatore ky standard plotësohet, por ka shumë hapësirë dhe punë për t'u bërë për të vënë studentët në qendër, dhe mbi të gjitha për një dinamikë që krijon sinergji dhe optimizëm në institucion.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	POLIS bën përpjekje për të ecur me hapin e kohës në lidhje me informimin e studentëve për procesin mësimor, aktivitetet e ndryshme që ndodhin. Një nga mjetet më të rëndësishme të informimit është faqja e internetit https://universitetipolis.edu.al/. POLIS ka një marketing shumë elegant përmes rrjeteve sociale të cilat impaktojnë gjeneratën Z. Në të njëjtën kohë, sistemi i email të intranetit, publikimet në stendat pranë departamenteve dhe dekanatit, komunikimet e pedagogëve verbale dhe përmes rrjeteve, përfshirë whatsapp group janë mjetet që përdoren për informimin e studentëve. <i>Dokumenti Aneksi 11.2: Vendimi për këshilluesit akademike</i>

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	POLIS ka të ngritur në nivel institucioni dhe këshillimin akademik, në dosjen e dokumentave gjejmë vendimin e Rektorit për përcaktimin e këshilluesve për çdo department. Këshilluesit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në rekrutimin e studentëve të rinj, klubet studentore dhe bashkëveprojnë me ZMSKK për shumë elementë të intershipeve dhe karrierë. Për ndjekjen e ecures mësimore, në shërbim të studentëve është sistemi PITAGORA, por dhe shumë informacione që në mënyrë të vazhduar merren përmes komunikimit ditë pas pas dite me sekretarinë dhe departamentin. Gjatë vizitës në institucion, studentët, stafi, drejtuesit dhe zyrat e ndryshme vlerësonin efektivitetin e një kanali komunikimi përkundrejt një tjetri. <i>Dokumenti Aneksi 11.2: Vendimi për këshilluesit akademike</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Studenti në qendër dhe ofrimi i një sërë shërbimesh për studentët, si këshillimi i karrierës, mundësitë për intershipe dhe punësime, orientimi për mobilitetet Erasmus dhe përfshirja në projekte, konferencat shkencore, etj është sot në thelbin e veprimtarisë së universiteteve. Prej disa vitesh në institucion funksionon Zyra e Mbështetjes së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Ndërkombëtarizimit dhe Projekteve dhe në këtë vit akademik këshilluesit akademike, të cilat kanë një aktivitet shumë proaktiv. Është pozitive që tashmë këto struktura po bëjnë përpjekje për t'i shërbyer studentëve, duke organizuar një sërë aktivitete, mes tyre dhe Panairi i Karrierës. Zyra e Mbështetjes së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me departamentet gjurmon studentët pas diplomimit, por ky nuk është rasti i këtij programi studimi. Gjatë takimit me studentët e programit të studimit, evidentuam një qasje shumë pozitive të tyre ndaj proceseve të informimit, mbështetjes dhe angazhimit. <i>Dokumenti Aneksi 11.2: Vendimi për këshilluesit akademike</i> <i>Dokumenti Aneksi 56: Programi i Panairit të Karrierës 2024</i> <i>Dokumenti Aneksi 55: Rregulore e funksionimit të ZMSKK</i> <i>Dokumenti Aneksi 57: Lista e kompanive pjesëmarrëse në Panairin e Karrierës</i>

	Dokumenti Aneksi 14: Aktivitetet e realizuara në programin e studimit Dokumenti Aneksi 13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit			
Konkluzione	GVJ evidenton që në lidhje me këtë standard në POLIS ka një angazhim të plotë për të vendosur studentin në qendër dhe për t'i shërbyer më së miri, në çdo fazë të procesit dhe formimit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur evidentohet se, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UP, janë ngitur dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit, si dhe koordinon punën me njësinë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, që është Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	NJSBC monitoron vlerësimet periodike dhe të dhënat e mbledhura nga studentët dhe stafi akademik trajtohen në formën e gjetjeve dhe pasqyrohen në formën e një raporti me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave për rastet kur është e nevojshme. Zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik asistent lektor vlerësohet çdo vit nëpërmjet një formulari të hartuar dhe miratuar në Dekanat në lidhje

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

	me disa elementë të tilla si: komunikimi, aftësia për të punuar në grup, cilësia e mësimdhënies, risitë dhe inovacioni në mësimdhënie, kërkimi shkencor etj. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Në përfundim të çdo semestri bëhet anketimi i studentëve përmes sistemit PITAGORA, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Gjetjet e pasqyruara në raport vihen në dispozicion përmes emailit, si dhe i prezantohen Senatit Akademik. Pjesë e këtyre vlerësimeve periodike të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve është edhe mundësia e trajtimit të ankimimeve. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Gjetjet e pasqyruara në raportin e NJSBC bëhen transparente dhe përcillen përmes emailit, si dhe i prezantohen Senatit Akademik, i cili organizon një mbledhje të hapur ku marrin pjesë stafi akademik, administrativ dhe përfaqësues të studentëve. Gjetjet e detajuara i përcillen secilit anëtarë të stafit në mënyrë individuale përmes emailit. Këto të dhëna bëhen pjesë edhe të Raportit Vjetor të UP. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sikurse përmendur edhe më sipër, rezultatet e vlerësimit përmbledhen dhe pasqyrohen në formën e një Raporti Vjetor, i cili i vihet në dispozicion Senatit Akademik. Gjetjet e raportit diskutohen në nivel njësie bazë/kryesore, me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave në vijim, në rastet kur ka. Në përputhje me këto gjetje, Departamentet, me miratimin e Dekanatit, rishikojnë metodologjinë, lëndët, literaturën, etj. me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe procesit të mësimdhënies në vijim. Gjithashtu, me qëllim nxitjen dhe promovimin e stafit, në UP hartohet Raporti Vjetor për Kërkimin Shkencor, në të cilin pasqyrohen rezultatet dhe arrijtet shkencore të stafit dhe mbi të cilin hartohet edhe sistemi i pikësimit. <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i>
Konkluzione	<i>Universiteti Polis ka të ngritura dhe funksionale struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe</i>

	<i>ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UP, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore, ka të ngritur dhe funksionale Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), si një njësi vlerësimi të përhershme, përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë, funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë, me përfaqësues të stafit akademik, stafit administrativ, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve aktualë dhe atyre alumni. Sipas Statutit të UP, kjo njësi ka për detyrë të bëjë vlerësimin e të gjithë elementëve të cilësisë sipas standardeve të ENQA-s, të vlerësojë periodikisht procesin mësimor, si dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Kjo njësi synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike, në mënyrë që çdo aspekt në UP të shihet në kuadër të cilësisë, përmes krijimit dhe konsolidimit të kulturës së cilësisë. NJBSC, me zgjerimin e fushës së saj të veprimtarisë, tashmë mbulon edhe funksionet kërkimore dhe administrative.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e	UP përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Një prej proceseve që ndihmon në përmirësimin e cilësisë është edhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucionit dhe programeve të studimit. Në kuadër të këtij procesi, i cili realizohet nga ASCAL, UP harton dhe përgatit Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit.

përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Një tjetër ndihmesë në kuadër të përmirësimit dhe promovimit të cilësisë, ka qenë edhe angazhimi i UP në projektin Erasmus+, Key Action 2, QAINAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", në të cilin kanë marrë pjesë staf të UP dhe anëtarë të NJBSC. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik realizohet nga 4 komponentë: 1. Vlerësimi nga studentët, pesha e së cilit zë 50% të vlerësimit total. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimin e tyre përmes një pyetësoi anonim, i cili realizohet elektronikisht përmes sistemit PITAGORA, lidhur me programin e studimit, lëndët, pedagogët, etj. 2. Vlerësimi nga kolegët, pesha e së cilit zë 35% të vlerësimit total. Ky vlerësim realizohet përmes ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët, bazuar në një kalendar nëpërmjet të cilit përcaktohen afatet kohore se kur duhet të përfundojë vlerësimi. 3. Vetë-vlerësimi, pesha e së cilit zë 15% të vlerësimit total. Përmes këtij vlerësimi dëshmohet shkalla e njohjes së vetë pedagogëve për cilësinë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual. 4. Vlerësimi nga drejtuesit, i cili realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar me analizat semestrale. Me stafin e ri, ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillimin, orientimin, njohjen me praktikën më të mira, me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik. Vlerësimi shërbim si vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik, duke përfshirë edhe punën shkencore dhe bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit. Gjithashtu, procese të tjera vlerësimi periodike të njësisë janë: - vlerësimi i proceseve administrative; - vlerësimi i performancës akademike mbi angazhimin në punët kërkimore; - hartimi i raporteve individuale dhe bashkëbisedimeve konstruktive mbi performancën vjetore të stafit akademik / administrativ;

	- hartimi i raportit vjetor të njësisë në fund të çdo viti akademik, rezultatet e të cilit i bëhen të ditura stafit dhe studentëve. Të gjitha gjetjet bëhen pjesë e Raporteve të pjesshme dhe vjetore të Njësisë, si dhe Raportit Vjetor të Institucionit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Polis harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni punon për të arritur rezultate sa më maksimale si në rritjen e procesit mësimor, ashtu edhe në promovimin e stafit akademik. Në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pah arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme. Programi i studimit vlerësohet në fund të çdo semestri, nga disa komponentë dhe rezultatet bëhen pjesë e një analize vjetore dhe pasqyrohet në formën e një raporti. UP ndjek dhe zbaton edhe mekanizma të tjera si grupe pune për probleme të veçanta, organet kolegjiale të përhershme brenda njësive kryesore, apo konsultimet me specialistë të fushës, brenda dhe jashtë institucionit. Gjetjet e këtyre vlerësimeve bëhen pjesë e Raporteve të pjesshme dhe vjetore të Njësisë, si dhe Raportit Vjetor të Institucionit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i>

	<i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pah arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme. Programi i studimit vlerësohet në fund të çdo semestri, nga disa komponentë dhe rezultatet bëhen pjesë e një analize vjetore dhe pasqyrohet në formën e një raporti. UP ndjek dhe zbaton edhe mekanizma të tjera si grupe pune për probleme të veçanta, organet kolegjiale të përhershme brenda njësive kryesore, apo konsultimet me specialistë të fushës, brenda dhe jashtë institucionit. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	UP përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. NJBSC është struktura përgjegjëse për realizimin e monitorimit të aktivitetit dhe rezultatet e tij i përcillen Rektoratit dhe Dekanateve, dhe gjithashtu rezultatet e pyetësorëve i përcillen edhe stafit e studentëve. Nga të dhënat e raportuara, janë nxjerrë rekomandime lidhur me rregullsinë e procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies, janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime në rastet kur ka qenë e nevojshme, etj. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e	NJBSC monitoron në mënyrë të vazhdueshme: mënyrën e zhvillimit të lëndëve, rishikimin/përditësimin e tyre; ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimit të tij; procesin e mësimdhënies, ruajtjen e cilësisë dhe vlerësimin nga studentët; ecurinë e kërkimit shkencor; ecurinë e bashkëpunimit

intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	ndërmjet njërive/strukturave brenda dhe institucionit; përfshirjen e studentëve në veprimtaritë akademike, konferenca, etj. Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm: 1. Vlerësimi nga studentët; 2. Vlerësimi nga kolegët; 3. Vetë-vlerësimi; 4. Vlerësimi nga drejtuesit. Gjithashtu, UP përdor e zbaton metoda të tjera si: sondazhe, takime të drejtpërdrejta, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve dhe punësimin e tyre, etj. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Dokumenti Aneksi 31: Formularët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i>			
Konkluzione	GVJ evidenton se Universiteti Polis përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit, si dhe metoda e instrumente të drejtpërdrejta e të tërthorta në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në aktet ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga 9 anëtarë, me përfaqësues të stafit akademik, stafit administrativ, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve aktualë dhe atyre alumni. Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për aktorët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Edhe gjatë vizitës në institucion me këtë njësi, u evidentua qartë ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë.

	Gjithashtu, rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit, i cili shërben si lidhje midis studentëve dhe njësive të cilësisë dhe njësive të tjera. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për aktorët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Edhe gjatë vizitës në institucion me këtë njësi, u evidentua qartë ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësive. Gjithashtu, rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit, i cili shërben si lidhje midis studentëve dhe njësive të cilësisë dhe njësive të tjera. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e POLIS rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacion, si dhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneseve me të cilat UP ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës, gjë që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu eksperiencia që stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësime të vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj. <i>UP ka të miratuar Rregulloren e Etikës, përmes së cilës bëhet e mundur ndërmjet të tjerash edhe mbrojtja nga diskriminimi apo pabarazia.</i> <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Polis përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. <i>Dokumenti Aneksi 03. Statuti i Universitetit POLIS</i> <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti Polis përfshin aktorë të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konfirmon se përpos dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni në lidhje me procedurat dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në faqen web të UP si, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë. Raportet që NJBSC harton mbi gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon, krahas shpërndarjes përmes e-mail, prezantohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik, ku marrin pjesë stafi i institucionit, si dhe përfaqësues të studentëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim. UP, në bërjen publike të informacioneve, respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë	Institucioni publikon rezultatet si është parashikuar në rregullore. Kështu sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët, rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve

dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sikurse është analizuar edhe më sipër, rezultatet e vlerësimit nga vlerësimet periodike mbledhen dhe pasqyrohen në formën e një raporti, i cili i përcillet Rektoratit dhe Senatit Akademik. Ky i fundit organizon një mbledhje të hapur me stafin e institucionit dhe përfaqësues të studentëve, për të diskutuar lidhur me gjetjet e raportit dhe përmirësime të mundshme të nevojshme në vijim. Bazuar në gjetjet e raportit, njësitë bazë dhe kryesore analizojnë rezultatet dhe marrin masa, kur është e nevojshme, për përmirësimin e metodologjisë, lëndëve, literaturës, etj. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raportet që NJBSC harton mbi gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon, krahas shpërndarjes përmes e-mail, prezantohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik, ku marrin pjesë stafi i institucionit, si dhe përfaqësues të studentëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim. UP, në bërjen publike të informacioneve, respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Dokumenti Aneksi 32: Rregullore e NJSBC Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online. Gjithashtu stafi akademik dhe ndihmës akademik kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë. <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe NJBSC</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë publike dhe transparente. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i>

87 Fer

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznes” të ofruar nga Universiteti Polis.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përvoja e Universitetit Polis dhe emri i mirë i krijuar në vite, lehtëson procesin e realizimit të programit të studimit në kërkesat e standardeve.
2. Lidhjet e programit me bizneset si dhe numri relativisht i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to është një shenjë e mirë e materializimit në terren të formimit teorik dhe konkretizimit të praktikave manaxheriale dhe financiare të lëndëve specifike.
3. Infrastrukturat në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe brenda standardeve duke krijuar mundësi dhe lehtësi për procesin e mësimdhënies.
4. Ngarkesa e numrit të studentëve për një pedagog nuk është e lartë, çka premt për ndjekjen e tyre edhe në veprimtaritë jashtë fakultetit.
5. Proaktiviteti në projekte lokale dhe ndërkombëtare

Pika të dobta:

1. Një pjesë e syllabuseve nuk kanë formatin standard që përmbajnë të gjithë elementët përkatës komfort ligjit. Gjithashtu, jo të gjithë syllabuset kanë të listuara tematikat për 14 javë që janë pjesë e semestrit dhe vetëm disa prej tyre kanë si referencë literaturë të viteve të fundit. *(Standardi II. 3, Kriteri 4)*
2. Ndërkohë që programi i studimit ofron lëndë inovatore për fushën e studimit, mungon ndërthurja e praktikës laboratorike dhe platformave dixhitale për realizimin e disa lëndëve që janë të një rëndësie të veçantë të trajtohen dhe në këto drejtime. *(Standardi II. 4, Kriteri)*
3. Numri i ulët i studentëve në program përbën një disavantazh, pasi ndikon në qëndrueshmërinë e tij, kufizon ndërveprimin akademik dhe ul efikasitetin në përdorimin e burimeve institucionale.
4. Pësia e lëndëve me fokus në biznes është relativisht e lartë, gjë që ndikon në balancën e programit dhe kufizon hapësirën për lëndë më të specializuara ose bashkëkohore.

Rekomandime:

1. Departamenti duhet të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të VKM Nr. 41, datë 21.01.2018, i ndryshuar, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen me Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, Departamenti duhet të marrë masa për sa në vijim:
 - a) të përdoret formati standard i detajuar me elementët përkatës sipas VKM 41/2018, i ndryshuar. Temat e lëndës të ketë si shpjegim prej rreth një paragrafi për çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe);
 - b) tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë;
 - c) literatura e përdorur të jetë e viteve të fundit.
2. Programi i studimit duhet të ketë ndërthurje të praktikave laboratorike dhe platformave dixhitale për realizimin e lëndëve të caktuara
3. IAL të kryejë një studim tregu të fokusuar në kompetencat që kërkohen në tregun shqiptar dhe europian, në përvoja europiane dhe rajonale të ngjashme, si dhe në sjelljet e qëndrimet e studentëve në këtë epokë të re – proces që sugjerohet pas akreditimit të parë të programit BA në AB
4. GVJ sugjeron hartimin e Rregullores së departamentit, Rregulloren e Praktikës Mësimore dhe tërësinë e dokumentave të praktikës, si dhe Manualin e Cilësisë
5. GVJ rekomandon disa përmirësime në strukturën e lëndëve që e përbëjnë këtë program, futjen e disa lëndëve të domosdoshme si dhe të lëndëve që lidhen me zhvillimet e fundit teknologjike, Ai përfshirë, zvogëlimin e peshës së lëndëve të biznesit, kalimi i disa lëndëve në MA dhe anasjelltas.
6. GVJ rekomandon rishikimin e planit mësimor për të plotësuar 4500 orët dhe raportin leksion seminar si dhe rishikimi i elementëve të kontrollit të dijes
7. GVJ sugjeron që Departamenti do të duhet të ketë ngjashmëri në programin BA në AB me shkolla të tjera, brenda vendit apo jashtë.
8. GVJ rekomandon përpilimin e Rregullores së Sekretarisë Mësimore, hartimi i një analizë vjetore nga ana e departamentit mbi të dhënat e saj si dhe një periodicitet vjetor i auditimit të sekretarisë.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Business Administration" provided by the Higher Education Institution "Polis University"

Strengths and affirmations

1. The experience of Polis University and the good reputation built over the years facilitate the implementation of the study program in accordance with standard requirements.
2. The program's connections with businesses, as well as the relatively high number of cooperation agreements, are a positive indicator of the practical application of theoretical knowledge and the realization of managerial and financial practices in specific courses.
3. The infrastructure available to the program is sufficient and meets the standards, creating opportunities and ease for the teaching process.
4. The student-to-lecturer ratio is not high, which allows for closer follow-up, including participation in activities outside the faculty.
5. Proactiveness in local and international projects.

Weaknesses

1. Some of the syllabuses do not follow the standard format that includes all the necessary elements in accordance with the law. Furthermore, not all syllabuses include weekly topics for the full 14 weeks of the semester, and only a few of them reference recent literature. **(Standard II.3, Criterion 4)**
2. While the study program offers innovative courses in the field, there is a lack of integration of laboratory practice and digital platforms for the delivery of certain subjects, which are particularly important to be addressed through these methods. **(Standard II.4, Criterion 4)**
3. The low number of enrolled students in the program represents a disadvantage, as it affects its sustainability, limits academic interaction, and reduces the efficiency of institutional resource utilization.
4. The weight of business-focused courses is relatively high, which affects the overall balance of the program and limits the space for more specialized or up-to-date subjects in the field.

Recommendation

1. The Department is required to undertake the necessary measures to ensure that this study program is fully aligned with the legal requirements set forth in the amended Decision of the Council of Ministers No. 41, dated 21.01.2018. In this context, and with the aim of improving and adapting the program in accordance with the amended DCM No. 41, dated 24.01.2018, the Department should take the following actions:
a) Adopt the standard detailed format, incorporating all relevant elements as prescribed by the amended DCM 41/2018. Each lecture topic should be accompanied by a brief explanatory paragraph corresponding to the weekly schedule, as well as the



- appropriate literature, clearly specified by page numbers;
b) Ensure the weekly distribution of course topics over a 14-week academic period;
c) Utilize up-to-date literature from recent years.
2. The study program should incorporate laboratory-based activities and digital platforms for the effective delivery of selected courses.
 3. The Higher Education Institution (HEI) is advised to conduct a comprehensive market study focused on the competencies demanded by the Albanian and European labor markets. This study should also take into account relevant European and regional experiences, as well as the behavioral trends and attitudes of students in the current era. This process is recommended to be undertaken following the initial accreditation of the BA program in AB.
 4. The Evaluation Group recommends the drafting and formal adoption of the Departmental Regulations, the Teaching Practice Regulations, the full set of documentation related to teaching practice, and the Quality Assurance Manual.
 5. The Evaluation Group further recommends improvements to the structure of the curriculum by introducing essential courses, including those that reflect recent technological developments (notably artificial intelligence), reducing the weight of business-oriented courses, and reassigning certain courses between the bachelor's and master's levels as appropriate.
 6. The Evaluation Group advises the revision of the teaching plan to ensure it meets the 4500-hour requirement and maintains an appropriate lecture-to-seminar ratio. Additionally, a review of the knowledge assessment components is recommended.
 7. The Evaluation Group suggests that the Department should align the BA program in AB with comparable programs offered by other institutions, both nationally and internationally.
 8. The Evaluation Group recommends the preparation and implementation of the Academic Secretariat Regulations, the compilation of an annual departmental analysis based on its data, and the establishment of an annual audit cycle for the Secretariat.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

